



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1387/24, Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë), nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031(GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Prishtinës për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Filozofi Politike MA 120 ECTS me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.*
- II. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Prishtinës për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 1. *Shkenca Politike BA 180 ECTS (me 2 specializime: 1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomacia dhe 2. Administrata Publike) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
 2. *Arkivistikë MA 60 ECTS, me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;*
 3. *Sociologji MA 120 ECTS, me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
 4. *Punë Sociale BA 180 ECTS, me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Filozofisë në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Filozofi Politike MA 120 ECTS</i>	Hasnija Ilazi Dorajet Imeri
2.	<i>Shkenca Politike (me 2 specializime) BA 180 ECTS.</i>	Adem Beha, Bardhok Bashota Zenun Halili, Arben Hajrullahu
3.	<i>Arkivistikë MA 60 ECTS,</i>	Ibrahim Gashi
4.	<i>Sociologji MA 120 ECTS,</i>	Gëzim Selaci Ardian Gola
5.	<i>Punë Sociale BA 180 ECTS R</i>	Lulëzim Dragidella, Vjollca Krasniqi Njomza Llullaku, Avdyl Gashi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Prishtinës.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Filozofi Politike MA 120 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Pavo Barisic, Michael Geary dhe Lali Giorgitze është organizuar më 29.04.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), ndërsa Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Shkenca Politike (me 2 specializime) BA 180 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Michael Geary, Pavo Barisic dhe Lali Giorgitze është organizuar më 29.04.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4), Substancialisht dy (2) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Arkivistikë MA 60 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Anna Bara dhe Juraj Bogat është organizuar më 17.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3), ndërsa Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.


4. **Për programin e studimit; Arkivistikë MA 60 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Pavo Barisic dhe Juraj Bogat është organizuar më 17.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5), ndërsa Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
5. **Për programin e studimit; Arkivistikë MA 60 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Stavros Parlaris dhe Juraj Bogat është organizuar më 17.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3), ndërsa Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Filozofisë në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë